

LIGJ
Nr. 124/2015

PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË*

(Ndryshuar me ligjin nr. 5/2019, datë 7.2.2019; nr. 28/2021, datë 8.3.2021; nr. 37, datë 16.6.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) hartimi i rregullave dhe politikave kombëtare për nxitjen, promovimin e përmirësimin e përdorimit eficient të energjisë, me synim kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit, si dhe heqjen e pengesave në tregun e energjisë;
- b) vendosja e objektivave kombëtarë të efikasitetit të energjisë;
- c) rritja e konkurrueshmërisë së operatorëve.

Neni 2

Objekti

Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe personave fizikë dhe /ose juridikë, publikë ose privatë, që ushtrojnë veprimtari në sektorët rezidencialë, të shërbimeve, industrisë, transportit, bujqësisë, si dhe të gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë, për nxitjen e përdorimit me efikasitet të energjisë dhe për zhvillimin e tregut për shërbimet energjetike.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për subjektet e mëposhtme:

- a) personat juridikë, që ushtrojnë veprimtari të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë;
- b) personat fizikë dhe/ose juridikë, publikë ose privatë, që janë konsumatorë fundorë të energjisë;
- c) personat fizikë dhe/ose juridikë, që sigurojnë shërbimet energjetike për përmirësimin e

* Ky ligj është përafshuar pjesërisht me direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012, "Për efikasitetin e energjisë, që ndryshon direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe shfuqizon direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE". Numri CELEX-32012L0027, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.315/1, datë 14.11.2012.

efiçencës së energjisë.

Neni 4

Përkufizime

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 5/2019, datë 7.2.2019; shfuqizuar pika 6, shtuar pikat 31 dhe 32, ndryshuar pika 11, shtuar pika 22/1, ndryshuar pika 27, shtuar pika 27/1 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Auditim energjetik” është procedura që ndiqet për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për profilin ekzistues të konsumit të energjisë së një ndërtese ose një grupi ndërtesash, të një objekti dhe/ose instalimi industrial, në pronësi ose përgjegjësi administrimi të një personi juridik, publik ose privat, me qëllim identifikimin dhe përllogaritjen e kostove dhe kursimeve të energjisë, raportimin e rezultateve dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të efiçencës së energjisë.

2. Auditues energjetik” është një person fizik i certifikuar ose person juridik që, ka të punësuar auditues energjie të certifikuar, i cili kryen auditime energjetike, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

3. Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë është institucioni përgjegjës për promovimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave e të politikave të efiçencës së energjisë.

4. “Energji” është çdo formë energjie e disponueshme në treg, përfshirë energjinë elektrike, gazin natyror (përfshirë gazin natyror të lëngshëm), gazin e lëngshëm të naftës, çdo lëndë djegëse për ngrohje dhe ftohje (përfshirë ngrohjen dhe ftohjen e përqendruar e rajonale), qymyrin dhe linjitin, torfën, karburantet për transport (duke përjashtuar karburantet e përdorura në aviacion dhe transportin detar), biomasën, energjinë diellore, energjinë e erës, energjinë gjeotermale dhe energjinë nga mbetjet urbane.

5. “Efiçenca e energjisë” është rezultati, në përqindje, i raportit ndërmjet sasisë së energjisë në dalje me sasinë e energjisë në hyrje.

6. Shfuqizuar.

7. “Furnizues” është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.

8. “Financimi nga palë të treta” është një kontribut financiar që i sigurohet përfituesit nga një palë e tretë, e ndryshme nga furnizuesi i energjisë, e cila siguron kapitalin financiar për zbatimin e plotë ose të pjesshëm të masave për përmirësimin e efiçencës së energjisë, duke i ngarkuar përfituesit detyrimin e një pagese që llogaritet mbi bazën e përfitimit që arrihet si rezultat i zbatimit të masave të përmirësimit të efiçencës së energjisë.

9. “Intensiteti i energjisë” është raporti i konsumit vjetor të energjisë nga konsumatorët fundorë me prodhimin e brendshëm bruto (GDP) të vendit.

10. “Konsumator fundor” është një person fizik ose juridik që blen energji vetëm për nevojat e tij.

11. “Konsumator i madh i energjisë” është një konsumator fundor, i cili ka konsum vjetor të energjisë më të madh se 1 milion kwh energji elektrike në vit.

12. “Konsumi primar i energjisë” është konsumi i brendshëm bruto i burimeve të energjisë, duke përjashtuar burimet që përdoren për qëllime joenergjetike.

13. “Konsumi final i energjisë” është konsumi total i të gjitha llojeve të energjisë që furnizojnë konsumatorët fundorë, duke përjashtuar konsumin e energjisë në sektorin e transformimit të energjisë dhe vetë industritë energjetike.

14. “Kursim i energjisë” është sasia e energjisë së kursyer, e përcaktuar nëpërmjet matjes dhe/ose përllogaritjes së konsumit, përpara dhe pas implementimit të një mase përmirësimi efiçence, kur nuk ndryshojnë kushtet e jashtme që ndikojnë në konsumin e energjisë.

15. “Kontraktimi i performancës energjetike” është një marrëveshje kontraktuale ndërmjet përfituesit dhe siguruesit të masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë, ku investimet në masa (puna, furnizimi apo shërbimi) paguhet nga përfituesi në raport me nivelin e përmirësimit të efikasitetit të energjisë, sikurse përcaktohet në marrëveshje.

16. “Masat e përmirësimit të efikasitetit të energjisë” është çdo masë që sjell përmirësime të verifikueshme dhe të matshme të efikasitetit të energjisë.

17. “Masa ndërsektoriale” është çdo masë e ndërmarrë nga subjektet publike e private, e cila ndikon në mënyrë të rëndësishme në përmirësimin e efikasitetit të energjisë”.

18. “Ministri” është ministri përgjegjës për energjinë.

19. “Mekanizmat e efikasitetit të energjisë” janë mekanizmat që ndërmerren nga institucionet ose agjencitë shtetërore përgjegjëse për energjinë për të krijuar një kuadër ose skema mbështetëse për pjesëmarrësit e tregut për ofrimin dhe blerjen e shërbimeve të energjisë, si dhe masa të tjera të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

20. “Ndërtesë” është një konstruksion me mure ose materiale të ngjashme, i mbuluar, në të cilin energjia përdoret për të plotësuar kërkesat për një ambient të brendshëm të përshtatshëm.

21. “Ndërtesë publike” është një ndërtesë në pronësi të shtetit ose në përgjegjësi administrimi nga një person juridik publik.

22. “Objekt industrial” është një ndërtesë e destinuar për ushtrimin e proceseve të ndryshme industriale.

22/1. “Organet e qeverisjes qendrore” janë të gjitha organet dhe institucionet e administratës shtetërore, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, përfshirë institucionin e Presidencës, Kuvendin dhe institucionet e pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj, kompetenca e të cilave shtrihet mbi të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

23. “Përmirësimi i efikasitetit të energjisë” është rritja e efikasitetit në përdorimin fundor të energjisë, si rezultat i ndryshimeve teknologjike dhe/ose sjelljeve ekonomike.

24. “Programe të përmirësimit të efikasitetit të energjisë” janë programe që synojnë financimin ose mbështetjen e veprimtarive, me qëllim përmirësimin e efikasitetit të energjisë, në grupe konsumatorësh fundorë.

25. “Performanca energjetike e një ndërtese” është sasia e përlllogaritur ose e matur e energjisë, e nevojshme për të plotësuar kërkesën për energji, lidhur me një përdorim normal të ndërtesës, që përfshin, ndërmjet të tjerash, energjinë e përdorur për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë dhe ndriçim.

26. “Produkt me ndikim në energji” është çdo produkt që ka një ndikim në konsumin e energjisë gjatë përdorimit të tij, përfshirë pjesët e projektuara për t’iu bashkuar produkteve me ndikim në energji, të cilat janë hedhur në treg ose janë vënë në punë si pjesë të veçanta për përdoruesit fundorë.

27. Rinovimi i konsiderueshëm është rinovimi i një ndërtese, ku më shumë se 25 për qind e sipërfaqes së ndërtimit të ndërtesës i nënshtrohet rinovimit, që nënkupton ndërhyrjen nëpërmjet rikonstruksionit dhe/ose ristrukturimit në mbështjelljen e jashtme dhe në sistemin teknik të ndërtesës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për performancën e energjisë në ndërtesa.

27/1. “Stoku i ndërtesave” është sipërfaqja totale e banueshme dhe e përdorshme e ndërtesave ekzistuese në territorin e Republikës së Shqipërisë, qofshin këto publike ose private, sipas përcaktimeve të nenit 4 dhe të pikës 7 të nenit 5 për të cilat zbatohet ligji nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave.

28. “Shërbime energjetike” është shërbimi dhe/ose produkti që përfitohet nga kombinimi i energjisë me teknologjinë e përdorur për përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe/ose masat, të cilat

përfshijnë operimet, mirëmbajtjen dhe kontrollin e nevojshëm për të siguruar efikasitetin e energjisë, sipas një kontrate, që vërtetohet se sjell përmirësime të verifikueshme dhe të matshme, ose të përlogaritura të efikasitetit të energjisë dhe/ose kursime të energjisë primare.

29. “Shoqëri e shërbimeve energjetike” është një person juridik që ofron shërbime energjetike dhe/ose masa të tjera të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

30. “Shpërndarës energjie” është një person juridik, përfshirë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, përgjegjës për transportin e energjisë, me qëllim lëvrimin e energjisë konsumatorëve fundorë, apo stacione shpërndarjeje që u shesin energji konsumatorëve fundorë.

31. “Agregatori” është një ofrues i shërbimit sipas kërkesës që kombinon ngarkesa të konsumatorëve të shumfshistë me kohëzgjatje të shkurtër për t’i shitur ose vendosur në ankand në tregjet e organizuara të energjisë.

32. “Autoritetet publike” janë autoritetet kontraktuese, siç përkufizohen në legjislacionin e zbatueshëm shqiptar për prokurimet publike.

KREU II POLITIKAT E EFICASITETIT SË ENERGJISË

Neni 5

Politikat e efikasitetit të energjisë

1. Në politikat kombëtare për përdorimin efikas të energjisë përcaktohen drejtimet për arritjen e objektivave kryesorë kombëtarë, mekanizmat, incentivat, aftësitë institucionale dhe financiare, si dhe kuadri i duhur ligjor për shmangien e çdo barriere ekzistuese tregu për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në vend.

2. Politikat kombëtare për përdorimin efikas të energjisë synojnë nxjerrjen e përfitimeve maksimale, përgjatë gjithë zinxhirit të përdorimit të energjisë, përfshirë prodhimin, transformimin, depozitimin, transmetimin, shpërndarjen dhe konsumin e energjisë në formë të ndryshme.

3. Politikat kombëtare për përdorimin efikas të energjisë duhet të marrin në konsideratë:

a) sigurimin e operimit normal të tregut energjetik, sipas kriterëve konkurrues të bazuara në kosto, si dhe të përfitimeve të mbrojtjes mjedisore.

b) promovimin e efikasitetit të energjisë nëpërmjet zbatimit të mekanizmave të ndryshëm financiarë, përfshirë edhe incentivat përkatëse, si dhe nxitjen e investimeve në këtë fushë;

c) transformimin e sektorit publik në një shembull model në menaxhimin efikas të energjisë, nëpërmjet investimeve, mirëmbajtjes, përdorimit të pajisjeve efikase që konsumojnë energji, shërbimeve energjetike dhe masave të tjera të përmirësimit të efikasitetit të energjisë;

ç) edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut e të përdoruesve të energjisë, lidhur me nevojën dhe përfitimet nga reduktimi i konsumit joefikas dhe joekonomik i energjisë;

d) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet konsumatorëve, prodhuesve, furnizuesve të energjisë dhe subjekteve publike, me qëllim arritjen e objektivave të vendosur në politikat kombëtare të përdorimit efikas të energjisë;

dh) mbështetjen e kërkimeve dhe adoptimin e teknologjive të reja në bashkëpunim me institucionet shkencore dhe ato universitare në fushën e përdorimit efikas të energjisë;

e) promovimin e iniciativave private dhe zhvillimin e shërbimeve me kosto efektive të efikasitetit të energjisë dhe ruajtjes së energjisë;

ë) shmangien e ndikimeve negative në mjedis dhe respektimin e prioriteteve sociale në promovimin e efikasitetit të energjisë, mbi bazën e ndryshimeve teknologjike, kulturore dhe/ose ekonomike;

f) bashkëpunimin me vendet e tjera në fushën e efikasitetit të energjisë dhe përmbushjen e angazhimeve e të detyrimeve të vendit, në kuadrin e çdo traktati ose konvente ndërkombëtare, në të cilat

Shqipëria është palë.

4. Gjatë hartimit të politikave dhe programeve të efikasitetit të energjisë merren në konsideratë karakteristikat e çdo rajoni të vendit dhe perspektivat e tyre për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

5. Ministria përgjegjëse për energjinë, me mbështetjen e agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, harton politikat kombëtare për efikasitetin e energjisë, si dhe monitoron zbatimin e këtyre politikave.

Neni 6

Objektivi kombëtar i kursimit të energjisë

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Këshilli i Ministrave, duke respektuar çdo angazhim të vendit tonë, si palë e Komunitetit të Energjisë dhe të procesit të integritetit në Bashkimin Europian, vendos një objektiv kombëtar të kursimit të energjisë, që bazohet në mundësitë reale ekonomike, konsumin primar ose atë final të energjisë, kursimin e energjisë primare ose finale, intensitetin e energjisë.

2. Objektivi kombëtar i kursimit të energjisë duhet të arrihet nëpërmjet shërbimeve energjetike, që synojnë rritjen e efikasitetit të energjisë në sektorë të veçantë të ekonomisë, si rezidencialë, të shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë, dhe marrjes së masave të tjera ndërsektoriale.

3. Objektivi kombëtar i kursimit të energjisë përcaktohet në Planin Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë dhe në Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës. Një kopje e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë i dërgohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 7

Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë

(Shtuar shkronjat "j" dhe "k" me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë hartohet nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës. Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë rishikohet çdo tre vjet dhe një kopje e tij i dërgohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

2. Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë përmban:

- a) objektivin për rritjen e efikasitetit të energjisë;
- b) objektivat e ndërmjetëm për çdo tre vjet;
- c) analizën dhe vlerësimin e arritjeve të planit të mëparshëm;
- ç) treguesit paraprakë dhe objektivat e veçantë për kursimin e energjisë në çdo sektor;
- d) veprimet dhe masat specifike të parashikuara për arritjen e objektivave të përgjithshëm dhe të ndërmjetëm kombëtarë të efikasitetit të energjisë;
- dh) detyrimet e organeve qendrore dhe vendore, lidhur me përmbushjen e veprimeve të parashikuara për rritjen e efikasitetit të energjisë;
- e) listën e akteve ligjore dhe nënligjore për arritjen e objektivave të efikasitetit të energjisë;
- ë) afatet kohore për përmbushjen e detyrimeve përkatëse;
- f) burimet e financimit, që do të përdoren për përmirësimin e efikasitetit të energjisë;
- g) informacion në lidhje me investimet e individëve, industrinë e ndërtimit dhe institucionet financiare;
- gj) një vlerësim të bazuar të kursimeve të pritshme të energjisë dhe përfitimeve të tjera që krijohen nga kursimi, në rast të marrjes së masave për rritjen e efikasitetit të energjisë;
- h) treguesit e performancës për vlerësimin e rezultateve të arritura dhe çdo informacion tjetër

të nevojshëm për këtë qëllim;

i) objektiva afatgjatë për realizimin e investimeve në sektorët rezidencialë, të shërbimeve, industrialë, të transportit e të bujqësisë, në funksion të efikasitetit të energjisë.

j) masat ndërsektoriale që zbatohen nga subjektet publike dhe private;

k) plani i veprimit afatgjatë për mobilizimin e investimeve për rinovime të stokut kombëtar të ndërtesave të banimit, atyre publike dhe të shërbimeve, qofshin këto publike dhe private;

Neni 8

Monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë

(Shtuar pika 6 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë monitoron zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të masave për efikasitetin e energjisë. Mbikëqyrja e zbatimit të masave për kursimin e energjisë kryhet në bazë të metodologjisë së llogaritjes së kursimit të energjisë, bazuar në treguesit e efikasitetit të energjisë në sektorët rezidencialë, të shërbimeve, industrialë, të transportit e të bujqësisë, e cila miratohet me udhëzim të ministrit.

2. Çdo veprimtari monitorimi, sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet bazuar mbi treguesit që gjenden në bazën e të dhënave kombëtare të energjisë. Në rast se tregues të caktuar nuk gjenden në bazën e të dhënave kombëtare, për qëllim monitorimi përdoren të dhëna të tjera të ngjashme, të cilat zbatohen nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

3. Forma dhe shpeshtësia e paraqitjes së raportimit mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë, sipas dis-pozitave të këtij ligji, përcaktohen me urdhër të ministrit.

4. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë raporton në ministri për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë, përfshirë rezultatet dhe objektivat e arritur, si dhe problemet e pengesat e hasura.

5. Ministri raporton një herë në vit në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë.

6. Agjencia përgjegjëse për Efikasitetin e Energjisë publikon rregullisht në faqen e saj zyrtare të gjitha raportet e përgatitura, sipas parashikimeve të pikave 3, 4 e 5 të këtij neni. Të gjitha veprimtaritë e monitorimit e të raportimit të kryera nga kjo agjenci raportohen në Platformën e Monitorimit dhe Verifikimit (MVP), e cila është një bazë e centralizuar të dhënash, që shërben si bazë për të analizuar e vlerësuar nëse janë arritur objektivat e efikasitetit të energjisë dhe për të hartuar raportin vjetor për progresin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë dhe të Planit të Integruar të Energjisë dhe Klimës. Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit miratohet nga Këshilli i Ministrave në përputhje me parashikimet në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

Neni 9

Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike

(Ndryshuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, përfshin në rregullat e prokurimit publik dispozita që detyrojnë autoritetet kontraktore publike për të blerë vetëm produkte, shërbime dhe ndërtesa me performancë të lartë të efikasitetit të energjisë, për sa kohë që kjo është në përputhje me efektivitetin e kostove, fizibilitetin ekonomik, qëndrueshmërinë më të gjërë, përshtatshmërinë teknike, si dhe konkurrencën e mjaftueshme, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës për prokurimet publike.

2. Kriteret teknike të referuara në pikën 1 të këtij neni përfshijnë:

a) kriteret specifike të detyrueshme lidhur me nivelet e efijencës së energjisë së produkteve dhe shërbimeve që përdoren nga autoritetet kontraktuese publike gjatë prokurimit publik të tyre. Këto kriterë aplikohen pavarësisht faktit nëse oferta ekonomikisht më e favorshme përdoret si kriter për përcaktimin e ofertës fituese. Kriteret u referohen standardeve shqiptare, evropiane dhe ndërkombëtare, të aplikueshme për të gjitha pajisjet e produktet që blihen nga autoritetet publike në Shqipëri. Nëse për një produkt të veçantë nuk ka asnjë standard shqiptar të aplikueshëm për efijencën e energjisë, zbatohen standardet ndërkombëtare dhe standardet përkatëse teknike në fuqi të Bashkimit Evropian për këtë produkt të veçantë;

b) një metodologji për mundësinë e aplikimit të pikëve shtesë që jepen nga autoritetet publike ndaj ofertuesve që tejkalojnë standardet minimale të efijencës së energjisë të përcaktuara në të, në rast se qasja e ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret si kriter për përcaktimin e ofertës fituese;

c) detyrimin e autoriteteve publike që t'i japin prioritet treguesit të efijencës së energjisë në rast se blejnë një paketë produktesh si një të vetme, në krahasim me efijencën e energjisë së produkteve individuale brenda asaj pakete, duke blerë në këtë mënyrë paketën e produktit që përputhet me kriterin, i cili i përket klasës më të lartë të efijencës së energjisë, pa anashkaluar gjithsesi kushtin e përmbushjes së standardeve minimale për të gjitha produktet e shërbimet individuale.

Neni 9/1

Planet vendore të veprimit për efijencë të energjisë, zbatimi dhe raportimi

(Shtuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Bashkitë përgatisin planet vendore të veprimit për efijencë të energjisë në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë dhe me Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës, të cilat përfshijnë politikat dhe masat për përmirësimin e efijencës së energjisë për të gjithë sektorët që funksionojnë në nivel lokal, mbi bazën e konsumit të energjisë në nivel lokal.

2. Para miratimit nga këshilli bashkiak, projektplanet vendore të veprimit për efijencë të energjisë konsultohen me ministrinë dhe agjencinë përgjegjëse për energjinë, si dhe me përfaqësues të grupeve të interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile, për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me politikat kombëtare të efijencës së energjisë dhe objektivat përkatës.

3. Plani vendor i veprimit për efijencë të energjisë dhe raporti i progresit për zbatimin e planit vendor të veprimit për efijencën e energjisë hartohen sipas formatit të miratuar nga ministri jo më vonë se 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Bashkitë, përmes menaxherëve të emëruar të energjisë, monitorojnë rregullisht zbatimin e planit dhe arritjen e objektivave të kursimit të energjisë. Për këtë qëllim, në përputhje me parashikimet në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, bashkitë krijojnë dhe mirëmbajnë bazën e të dhënave për konsumin e energjisë në objektet nën kontrollin e tyre dhe monitorojnë kursimet e realizuara nga zbatimi i masave në ndërtesat publike, sistemet e ujësjellësve, të ndriçimit dhe të gjitha aktivitetet me konsum të lartë të energjisë.

5. Bashkitë promovojnë në nivel vendor politikat kombëtare për efijencën e energjisë dhe informojnë qytetarët për përfitimet nga masat për rritje të efijencës së energjisë dhe mënyrën e realizimit të tyre.

Neni 9/2

Masat ndërsektorale

(Shtuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Masat ndërsektorale përcaktohen në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe në Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës, sipas parashikimeve të nenit 7 të këtij ligji. Këto masa zbatohen nga subjektet publike e private, që detyrohen për zbatimin e masave për eficiencën e energjisë dhe përfshijnë ndër të tjera:

a) standarde dhe norma të miratuara nga autoritetet përgjegjëse për energjinë, që synojnë përmirësimin e eficiencës së energjisë së produkteve dhe shërbimeve, si dhe përmirësimet në ndërtesa;

b) skemat e informacionit dhe të etiketimit të energjisë;

c) sistemet inteligjente të matjes, të tilla si: pajisjet individuale të matjes, matësit me dy drejtime për vetëprodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, sistemet e matjes të menaxhuara nga larg dhe sistemet informuese të faturimit;

ç) trajnimin dhe edukimin që çon në aplikimin e teknologjisë dhe/ose teknikave të eficiencës së energjisë;

d) rregulloret dhe propozimet për reduktimin e taksave, të cilat kanë efektin e reduktimit të konsumit final të energjisë dhe në mënyrë të veçantë të CO₂ dhe të gazeve serrë;

dh) fushatat që fokusohen në informimin dhe promovimin e përmirësimit të eficiencës së energjisë dhe masat që duhen ndërmarrë, me qëllim përmirësimin e eficiencës së energjisë.

2. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë mundëson bashkëpunimin dhe konsultimet ndërmjet subjekteve publike dhe private gjatë miratimit të masave ndërsektorale të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9/3

Rinovimi i ndërtesave

(Shtuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Për mobilizimin e investimeve për rinovime të stokut kombëtar të ndërtesave rezidenciale, të atyre publike dhe të shërbimeve, qofshin këto publike dhe private, miratohet një plan veprimi afatgjatë si pjesë përbërëse e Planit të Integruar të Energjisë dhe Klimës. Ky plan afatgjatë veprimi përfshin:

a) një vlerësim të përgjithshëm për konsumin e energjisë së stokut të ndërtesave në nivel kombëtar, bazuar në të dhënat statistikore kombëtare të sipërfaqeve të banueshme;

b) identifikimin e qasjeve me kosto efektive për rinovimet që lidhen me tipologjinë dhe funksionalitetin e ndërtesës sipas zonave klimatike;

c) politikat dhe masat lehtësuese fiskale për nxitjen e rinovimeve me kosto efektive të ndërtesave në nivel kombëtar;

ç) masat orientuese në vendimet e investimeve për ndërtesat private, industrinë e ndërtimit dhe pjesëmarrjen e institucioneve financiare;

d) një vlerësim të bazuar në studimet për minimizimin e konsumit të energjisë për stokun kombëtar të ndërtesave dhe identifikimin e kursimeve të pritshme të energjisë.

dh) përfshirjen në rinovimin e ndërtesave të stokut kombëtar të sistemeve të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme për vetëkonsum, sipas parashikimeve të legjislacionit për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme.

2. Plani i veprimit afatgjatë për mobilizimin e investimeve për rinovime të stokut kombëtar të ndërtesave të banimit, të atyre publike dhe të shërbimeve, qofshin këto publike dhe private, miratohet një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe përditësohet çdo 3 (tre) vjet. Në përputhje me pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji, ky plan i dorëzohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Neni 9/4

Roli model i ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore

(Shtuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Duke filluar nga data 1.4.2022, sektori publik ngarkohet me zbatimin e objektivit që 3% (tre për qind) e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike me ngrohje dhe/ose ftohje, në pronësi dhe të zëna nga organet e qeverisjes qendrore, dhe 2% (dy për qind) e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave të tjera publike të rinovohet çdo vit për të përmbushur kërkesat minimale për performancën e energjisë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton vendimin që përcakton sasinë në përqindje të sipërfaqes së stokut të ndërtesave publike për t'u rinovuar çdo vit kundrejt sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike. Ky vendim i Këshillit të Ministrave përfshin:

a) një metodologji të veçantë që përdoret për përcaktimin e sipërfaqes së stokut dhe llogaritjen e përqindjes përkatëse të ndërtesave publike;

b) përcaktimin e sipërfaqes totale të ndërtesave publike;

c) tipologjinë e ndërtesave që kërkohet të respektojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe të atyre të përjashtuara nga ky detyrim;

ç) zbatueshmërinë mbi ndërtesat e shfrytëzuara nga organet e qeverisjes qendrore, vendore dhe ato të vartësisë; dhe

d) masa të tjera, të cilat zbatohen për të mundësuar rinovimin tërësor të ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave, i përmendur në pikën 2 të këtij neni:

a) përcakton si objektiv ndërtesat e organeve të qeverisjes qendrore me performancën më të ulët të energjisë, të cilat kanë përparësi lidhur me masat për efikasitetin e energjisë, kur kjo është e mundur si nga pikëpamja e kostos efektive, ashtu edhe teknikisht e realizueshme;

b) hartohet në përputhje me përmbajtjen e planit të veprimit afatgjatë të përshkruar në nenin 9/3 të këtij ligji.

4. Ministri nëpërmjet agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë miraton e publikon inventarin e ndërtesave me ngrohje dhe/ose ftohje të organeve të qeverisjes qendrore, me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme mbi 250 m². Inventari përfshin:

a) sipërfaqen totale të kateve në metra katrorë; dhe

b) performancën aktuale të energjisë së secilës ndërtesë ose të dhënat përkatëse që lidhen me energjinë, duke përcaktuar objektivin e performancës.

5. Me qëllim përgatitjen e inventarit, ministri, përmes agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, u dorëzon një kërkesë për dhënie të informacionit të nevojshëm sipas pikës 3 të këtij neni subjekteve përkatëse të sektorit publik, të cilat janë të detyruara të japin informacionin e kërkuar për stokun brenda afatit të përcaktuar në kërkesë.

Neni 10

Menaxheri i energjisë

1. Personat juridikë, publikë ose privatë, që kategorizohen si konsumatorë të mëdhenj energjie, janë të detyruar të caktojnë një menaxher energjie.

2. Menaxheri i energjisë është përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve që konsumojnë çdo formë energjie, përmirësimin dhe mbikëqyrjen e mënyrave të përdorimit të energjisë dhe kryerjen e detyrave të tjera për përdorimin racional të energjisë në ndërtesa dhe industri.

3. Menaxheri i energjisë duhet të ketë kualifikimet dhe njohuritë profesionale, si dhe eksperiencë

praktike në kursimin e energjisë.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kategoritë, kushtet, dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherin e energjisë.

Neni 11

Masat për kursimin e energjisë nga konsumatorët e mëdhenj

(Shtuar pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë marrin masa për përmirësimin e menaxhimit të energjisë, si dhe formulojnë e zbatojnë masa teknike për kursimin e energjisë, me synim reduktimin e konsumit të energjisë.

2. Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë, përveç objektivave sektorialë të kursimit të energjisë, parashikon objektivat individualë për kursimin e energjisë për konsumatorët e mëdhenj.

3. Çdo person juridik që kategorizohet si konsumator i madh energjie, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas marrjes së rezultateve të auditimit energjetik dhe masave të identifikuar në raportin e auditimit harton një plan veprimi në përputhje me objektivat individualë për kursimin e energjisë, të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, për zbatimin e masave të përzgjedhura prej tij, duke garantuar arritjen e një kursimi të energjisë prej të paktën 4% (katër përqindësh) të energjisë ekuivalente totale të konsumuar prej tij.

4. Plani i veprimit përmban masat e përzgjedhura për zbatim, arsyen e përzgjedhjes, koston dhe afatin e realizimit për çdo masë dhe kursimet e pritshme të energjisë para investimit. Plani regjistrohet në regjistrin kombëtar që administron agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë.

5. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, që kanë certifikuar sistemin e tyre të menaxhimit të energjisë sipas standardit ISO 50001 nga një organ certifikues i sistemeve të menaxhimit të energjisë i akredituar, përjashtohen nga detyrimet e këtij neni, por janë të detyruar të raportojnë brenda datës 28 shkurt të çdo viti masat e zbatuara dhe kursimet e arritura gjatë vitit paraardhës pranë agjencisë përgjegjëse për eficiencën e energjisë dhe të rishikojnë planet e tyre pas çdo raporti auditimi të detyruar.

6. Format i planeve të veprimit të konsumatorëve të mëdhenj dhe i raportit vjetor të progresit miratohet nga ministri, me propozim të agjencisë përgjegjëse për eficiencën e energjisë.

7. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, që kanë certifikuar sistemin e tyre të menaxhimit të energjisë sipas standardit ISO 50001 nga një organ certifikues i sistemeve të menaxhimit të energjisë i akredituar, duhet të dërgojnë pranë agjencisë përgjegjëse për eficiencën e energjisë certifikatën ISO 50001 brenda 6 muajsh nga publikimi i këtij ligji në Fletoren Zyrtare.

Neni 11/1

Skema detyruese për eficiencën e energjisë dhe masat alternative

(Shtuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Për të siguruar përdorimin racional dhe eficient të burimeve energjetike në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikën e eficiencës së energjisë të vendosur sipas këtij ligji, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton çdo 10 vjet objektivat e kursimeve kumulative të konsumit final të energjisë në nivel kombëtar, duke filluar nga data 31.12.2021.

2. Me qëllim arritjen e objektivit kombëtar të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton një skemë detyruese për eficiencën e energjisë për operatorët e sistemeve të shpërndarjes dhe furnizuesit me pakicë të tregut të energjisë në Republikën e Shqipërisë.

3. Për qëllime të llogaritjes së objektivit kombëtar, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ministri, me propozim të agjencisë përgjegjëse për eficiencën e energjisë, miraton udhëzuesin që

përcakton mënyrën e llogaritjes së objektivit të kursimeve kumulative të konsumit final të energjisë dhe masat që duhet të miratohen për arritjen e tij.

4. Ministri, përmes agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, administron skemën detyruese për efikasitetin e energjisë dhe monitoron zbatimin e rregullave e të dispozitave detyruese sipas udhëzimit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Objektivat kumulativë të kursimit për konsumatorët fundorë, të cituar në pikën 1 të këtij neni, specifikohen në Planin e Integruar të Klimës dhe Energjisë dhe kontribuojnë në arritjen e objektivit kombëtar të efikasitetit të energjisë të përcaktuar në këto plane.

Neni 12

Marrëveshjet vullnetare

(Ndryshuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Marrëveshjet vullnetare lidhen ndërmjet konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, bizneseve të vogla dhe të mesme industriale dhe pronarëve të ndërtesave me kompanitë e shërbimeve energjetike, sipas modelit të marrëveshjes së miratuar nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, për të mbështetur zbatimin e masave dhe aktiviteteve të efikasitetit të energjisë, për arritjen e objektivave kombëtarë të sektorëve që mbulon efikasitetin e energjisë, si dhe vetë objektivin që do të arrijë marrëveshja.

2. Marrëveshjet vullnetare të përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të jenë transparente, jodiskriminuese dhe të përmbajnë të paktën:

a) objektivat specifikë dhe detyrimet e çdo subjekti për zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë;

b) mënyrat e veprimet mbështetëse për arritjen e objektivave dhe zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë;

c) metodologjinë që zbatohet për vlerësimin e kursimeve dhe të objektivit specifik;

ç) të drejtën e agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë për monitorimin dhe vlerësimin e masave të efikasitetit të energjisë dhe detyrimin e palës tjetër për raportim;

d) sanksionet në rast të mospërbushjes së detyrimeve dhe procedurat e zgjidhjes së kontratës.

3. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë ose çdo palë e tretë e pavarur dhe e emëruar nga kjo e fundit mund të marrë përsipër të kryejë një vlerësim të koston e të përfitimit për marrëveshjen e propozuar vullnetare në mënyrë që të konfirmojë koston për efikasitetin e energjisë si koston optimale në ngjashmëri me praktikën më të mirë në vende të tjera.

4. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë ndërmerr aktivitete për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit për përfitimet nga marrëveshjet vullnetare dhe nxit subjektet e mundshme të marrin pjesë në këto marrëveshje.

KREU III

INFORMACIONI PËR EFIKASITETIN E ENERGJISË DHE MATJA

Neni 13

Baza e të dhënave të energjisë

(Ndryshuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë realizon monitorimin e verifikimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë, duke përfshirë planet vendore të veprimit për

efiçencën e energjisë, kontratat për shërbimet energjetike dhe marrëveshjet vullnetare nëpërmjet Platformës së Monitorimit dhe Verifikimit.

2. Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit, sipas pikës 1 të këtij neni, shërben si bazë për të vlerësuar nëse janë arritur objektivat e efiçencës së energjisë sipas këtij ligji dhe për të hartuar raportin vjetor për progresin e zbatimit të PKVEE-së.

3. Shpërndarësit e energjisë dhe shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë i paraqesin agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë të paktën një herë në vit informacione të përmbledhura statistikore për konsumatorët e tyre fundorë.

4. Informacioni, sipas pikës 3 të këtij neni, përmban informacion historik dhe aktual lidhur me konsumin e përdoruesve fundorë, përfshirë, kur është e mundur, profile të ngarkesës, segmentimin e konsumatorëve dhe vendndodhjen gjeografike të tyre, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit, që është i karakterit privat ose i ndjeshëm nga pikëpamja tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Për sektorët rezidencialë, të shërbimeve, të industrisë, të transportit dhe të bujqësisë, agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë, në bashkëpunim me INSTAT-in, bën sondazhe për të dhënat për konsumin e energjisë nga konsumatorët në këta sektorë.

Neni 14

Matja

(Shtuar pikat 1/1 dhe 1/2 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë i kërkon subjekteve që kanë në përgjegjësi administrimi ndërtesa apo objekte industriale, të marrin masa për pajisjen e konsumatorëve fundorë me matës individualë të konsumit përfundimtar të energjisë, për çdo formë energjie që shpërndahet nga një rrjet qendror.

1/1. Për qëllime të matjes së konsumit aktual, përfshirë këtu rastin e matjes dhe faturimit të konsumit individual në rastet e sistemeve qendrore të ngrohjes ose ftohjes në ndërtesa me shumë njësi, ambiente individuale familjare të tilla, si: apartamente e vila, të furnizuara nga rrjeti i ngrohjes ose ftohjes qendrore ose nga një burim qendror ngrohjeje i instaluar e që i shërben vetëm kësaj ndërtese, qoftë në sektorin e energjisë elektrike, ashtu edhe në atë të gazit natyror, ose nga një impiant i prodhimit të energjisë termale, instalohen sisteme matësish inteligjentë në përputhje me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi për sektorin e energjisë dhe të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi për sektorin e gazit natyror.

1/2. Të gjitha faturat për energjinë elektrike të konsumuar dhe materialet promovuese të lëshuara nga furnizuesi përmbajnë informacione të qarta në përputhje me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi për sektorin e energjisë dhe parashikimet e zbatueshme të legjislacionit në fuqi për sektorin e gazit natyror. Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë bashkëpunon dhe koordinon punën me Entin Rregullator të Energjisë për transparencën e informacionin që duhet të përfshihet në faturat përkatëse, që do t'u lëshohen të gjithë konsumatorëve fundorë për konsumin aktual të tyre, sipas këtij neni.

2. Aty ku përdorimi i matësve individualë nuk është teknikisht i realizueshëm dhe aty ku ndërtesat me shumë apartamente furnizohen nga rrjeti i ngrohjes/ftohjes qendrore apo ku sistemet e ngrohjes/ftohjes janë të përbashkëta, agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë harton rregulla transparente për ndarjen e konsumit të energjisë termike te konsumatorët fundorë.

3. Ministri, me propozimin e agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë, miraton një udhëzim për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike, siç parashikohet nga ky nen.

Neni 15

Informacioni dhe trajnimi
(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë publikon, nëpërmjet faqes së saj zyrtare të internetit, ose botimeve të ndryshme, çdo informacion për mekanizmat e efikasitetit të energjisë dhe kuadrin financiar e ligjor të miratuar, me qëllim arritjen e objektivit kombëtar të kursimit të energjisë.

2. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë merr masa për të nxitur e lehtësuar përdorimin efikas të energjisë nga konsumatorët e vegjël të energjisë, përfshirë këtu konsumatorët shtëpiakë. Këto masa përfshijnë një ose disa nga elementet e listuara më poshtë:

a) një sërë instrumentesh dhe politikash për të promovuar ndryshimin e sjelljes së konsumatorit që mund të përfshijë:

- i. mundësi për të përfituar financim, grante ose subvencione;
- ii. dhënie informacioni;
- iii. projekte shembull/model;
- iv. aktivitete në vendin e punës.

b) mënyra dhe mjete për të angazhuar konsumatorët dhe grupimet e konsumatorëve gjatë instalimit fillestar të matësve inteligjentë përmes komunikimit të:

- i. kostove efektive dhe ndryshimeve lehtësisht të arritshme në përdorimin e energjisë;
- ii. informacionit për masat e efikasitetit të energjisë.

3. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë organizon trajnime për përfaqësuesit e institucioneve qendrore, përfaqësuesit e autoriteteve vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë mbi legjislacionin për efikasitetin e energjisë, si dhe për masat për implementimin e këtij legjislacioni.

4. Ministri miraton një udhëzim mbi llojin dhe periodicitetin e informacionit që do të vihet në dispozicion nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, siç parashikohet nga ky nen.

Neni 15/1
Nxitja e efikasitetit të energjisë në ngrohje dhe ftohje
(Shtuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Për të nxitur efikasitetin e energjisë në ngrohje dhe ftohje, përfshirë kogjenerimin me efikasitet të lartë, ministria, nëpërmjet agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, kryen një vlerësim gjithëpërfshirës të potencialit për aplikimin e kogjenerimit me efikasitet të lartë, si dhe të ngrohjes e ftohjes efikente. Elementet, kërkesat dhe parimet e përgjithshme të analizës së kostos dhe përfitimit të një vlerësimi të tillë rregullohen nëpërmjet udhëzimit të ministrit.

2. Vlerësimi gjithëpërfshirës i përmendur në pikën 1 të këtij neni, bazohet në analizën e kostos dhe të përfitimit që merr në konsideratë kushtet klimatike, fizibilitetin ekonomik dhe përshtatshmërinë teknike, me qëllim identifikimin e zgjidhjeve efikente për plotësimin e nevojave për ngrohje, ftohje dhe energji elektrike.

3. Kur vlerësimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe analiza e përmendur në pikën 2 të këtij neni identifikojnë një mundësi për aplikimin e kogjenerimit me efikasitet të lartë dhe/ose njësi qendrore të ngrohjes dhe ftohjes, përfitimet e të cilave tejkalojnë kostot, ministria bashkëpunon ngushtësisht me autoritetet bashkiake për vënien në zbatim të masave të përshtatshme për mbështetjen dhe zhvillimin e infrastrukturës efikente të njësive qendrore të ngrohjes ose ftohjes, ose kogjenerimin me efikasitet të lartë, përfituar nga çlirimi i nxehtësisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë.

KREU IV AUDITIMET DHE SHËRBIMET ENERGJETIKE

Neni 16

Auditimi energjetik

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 5/2019, datë 7.2.2019; shfuqizuar shkronja "b" e pikës 4 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Auditimet energjetike kryhen nga auditues energjetikë të certifikuar ose nga persona juridikë, që kanë të punësuar auditues energjetikë të certifikuar, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin:

- a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik;
- b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik;
- c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme;
- ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse.

3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm.

4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për:

- a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie;
- b) Shfuqizuar.

5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

- a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij neni;
- b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.

6. Çdo person juridik që kategorizohet si konsumator i madh energjie dhe është subjekt i auditimit të detyrueshëm, duhet që, brenda dy vjetësh nga marrja e rezultateve të auditimit, të ndër-marrë masat dhe kryejë veprimet e rekomanduara për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

7. Personat fizikë ose juridikë, subjekt i auditimit energjetik, paguajnë shpenzimet e kryera nga audituesi, si dhe shpenzimet për zbatimin e masave të dhëna nga audituesi për kursimin e energjisë.

8. Format i auditimit energjetik dhe pagesa për audituesin energjetik përcaktohen në rregulloren e hartuar nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë dhe të miratuar nga ministri dhe ministri përgjegjës për ndërtimin.

Neni 17

Audituesi energjetik

(Ndryshuar me ligjin nr. 5/2019, datë 7.2.2019; ndryshuar pikat 1 e 2 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021; shfuqizuar shkronja "a" e pikës 1 me ligjin nr. 37, datë 16.6.2025)

1. Auditimi energjetik, në kuptim të këtij ligji, kryhet nga auditues energjetikë të pavarur, të cilët certifikohen nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë dhe regjistrohen në regjistrin e saj elektronik. Procedura e certifikimit të audituesit energjetik miratohet nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, për secilën nga kategoritë e mëposhtme të audituesve energjetikë:

- a) shfuqizuar;
 - b) auditues energjetikë që kryejnë auditime energjetike në të gjitha objektet industriale, duke përfshirë këtu centralët e transformimit të energjisë;
 - c) auditues energjetikë që kryejnë auditime energjetike në të gjitha mjetet e sektorit të transportit.
- Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë mban në çdo kohë regjistrin e përditësuar të

audituesve të energjisë, të certifikuar në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave të përcaktuar në këtë pikë, si dhe publikon e përditëson këtë listë në faqen e saj zyrtare të internetit.

Rezultatet e auditimeve energjetike mund të transferohen te një ofrues i shërbimeve energjetike, që konsumatori zgjedh bazuar në kushtin që konsumatori të mos ketë vërejtje në lidhje me këtë.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimit në përmbajtje të pikës 1 të këtij neni, rregullon:

a) kategoritë dhe kërkesat minimale të kualifikimit të audituesve energjetikë së bashku me autorizimin e tyre për të kryer auditime në objekte të ndryshme;

b) përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e institucioneve të miratuara të edukimit dhe/ose trajnimit, të cilat janë të autorizuar nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, të kryejnë trajnime, duke përfshirë kualifikimet minimale, kapacitetet dhe objektet që këto institucione duhet të zotërojnë;

c) një listë të trajnimeve të detyrueshme profesionale që duhet të përfshijnë të paktën trajnimin për legjisllacionin përkatës kombëtar, standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e auditimit energjetik dhe menaxhimit energjetik, trajnime teknike për teknikat e auditimit energjetik, teknikat e analizës së kostove, teknikat e shkrimit të një raporti auditimi;

ç) parashikimin e kryerjes së testimeve përfundimtare, vlerësimin e rezultateve dhe certifikimin e atyre që kanë përfunduar me sukses programet e trajnimit;

d) rregulla procedurale për lëshimin e certifikatave audituesve energjetikë të certifikuar më parë nga institucione trajnuese;

dh) rregulla procedurale për njohje të audituesve të certifikuar energjetikë të huaj;

e) kodin e sjelljes së audituesve energjetikë;

ë) raportimet e detyrueshme në agjencinë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë;

f) metodat e procedurat për të krijuar dhe mirëmbajtur regjistrin elektronik të auditimeve energjetike dhe të audituesve energjetikë;

g) metodat e procedurat për kontrollin e cilësisë së auditimeve energjetike dhe audituesve energjetikë, bazuar në kontrollin të paktën të një përqindjeje të konsiderueshme statistikore të raporteve të auditimit energjetik që ata realizojnë;

gj) vendosjen e kriterëve minimale transparente dhe jodiskriminuese për të garantuar cilësinë e lartë të auditimeve energjetike dhe sistemeve të menaxhimit energjetik;

h) arsyet e procedurat për revokimin e përhershëm dhe heqjen nga regjistri të audituesve, për shkak të performancës së dobët e shkeljes së kodit të sjelljes.

3. Audituesi energjetik detyrohet të regjistrojë në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e veprimtarisë së audituesit energjetik.

4. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë mban regjistrin kombëtar për personat fizikë dhe juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitet si auditues energjetikë.

5. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:

a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;

b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;

c) është i afërm i shkallës së dytë i personit, që, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.

6. Audituesi energjetik mban konfidencialitet të gjitha të dhënat lidhur me personin fizik ose juridik, të përftuara në kuadrin e auditimit të kryer në objektet energjetike të këtij personi. Audituesi energjetik nuk duhet të përfitojë nga këto të dhëna dhe nuk duhet t'i përdorë në interes ose në dëm të subjektit të audituar apo të një pale të tretë. Detyrimi i konfidencialitetit mund të hiqet me miratimin me shkrim nga personi fizik ose juridik, objekt i auditimit energjetik, ose nëse bërja publike e tyre parashikohet nga një ligj tjetër.

7. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, me iniciativën e saj, pas një procedure në

përputhje me legjislacionin në fuqi, që i garanton audituesit të certifikuar të drejtën për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar dhe për t'u ankuar lidhur me shkeljen, vendos revokimin e certifikatës të audituesit energjetik në rast se:

a) provohet se në procesin e auditimit energjetik janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore;

b) provohet se audituesi bën publik informacionin dhe të dhënat e shoqërisë, si dhe sekretet tregtare të konsumatorëve, me të cilat ai është njohur për shkak të auditimit, me kusht që publikimi i tyre të jetë ankimuar nga subjekti i audituar.

8. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë njofton me shkrim audituesin energjetik për vendimin e tij për revokimin e certifikatës, sipas pikës 7 të këtij neni.

9. Një auditues energjetik, të cilit i është revokuar certifikata, sipas pikës 7, të këtij neni, ka të drejtë të aplikojë për certifikatë të re jo më herët se tre vjet nga data e marrjes së vendimit të mësipërm. Në rast se të njëjtit person i revokohet certifikata për herë të dytë, atëherë ky person nuk ka më të drejtë të aplikojë për certifikatë.

Neni 18

Shërbimet energjetike

(Ndryshuar pika 2, shtuar fjalë në pikën 3 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr. 5/2019, datë 7.2.2019; ndryshuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Shërbimet energjetike ofrohen nga shoqëri të specializuara për shërbimet energjetike (ESCO), të cilat duhet të jenë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Drejtuesit teknikë të shoqërive që ofrojnë shërbimet energjetike janë audituesit energjetikë të certifikuar. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë publikon e përditëson në faqen e saj zyrtare të internetit një listë të ofruesve të disponueshëm të shërbimeve energjetike.

2. Shërbimet energjetike ofrohen mbi bazën e kontraktimit të performancës energjetike sipas një modeli kontrate, i cili do të miratohet përmes një udhëzimi të ministrit, me propozimin e agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë.

3. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë publikon në faqen e saj të internetit:

a) praktikat më të mira për kontraktimin e performancës së energjisë, udhëzimet, kontratat model, përfshirë dispozitat që duhet të përfshihen në kontrata të tilla, për të garantuar kursimet e energjisë dhe të drejtat e konsumatorëve fundorë;

b) listën e përditësuar të ofruesve të kualifikuar/certifikuar të shërbimeve energjetike shoqëruar me dokumentacionin përkatës për kualifikimet/certifikatat e tyre, ose sigurimin e një ndërfaqeje ku ofruesit e shërbimeve energjetike mund të ofrojnë këtë informacion;

c) informacion për çdo instrument financiar në dispozicion, masa stimuluese, grante dhe kredi për të mbështetur projektet e shërbimeve të efikasitetit të energjisë;

ç) pikat përkatëse të kontaktit, ku klientët fundorë mund të marrin informacionin e nevojshëm.

Neni 18/1

Efikasiteti e energjisë në transformim, transmetim dhe shpërndarje

(Shtuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe shitësit e energjisë me pakicë janë të detyruar të tërhiqen nga çdo aktivitet (si pengesa në vendosjen e matësve të bilancit, në instalimin e pajisjeve për prodhimin e energjisë për vetëkonsum ose ndërhyrjen në linja për reduktimin e humbjeve dhe auditimin energjetik të këtyre operatorëve etj.) që mund të pengojë kërkesën dhe ofrimin e shërbimeve energjetike ose masa të tjera të përmirësimit të efikasitetit të energjisë së

energjisë, ose të pengojë zhvillimin e tregjeve për shërbime ose masa të tilla.

2. Enti Rregullator i Energjisë siguron heqjen e atyre masave stimuluese në tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes, që në mënyrë të panevojshme rrisin volumin e energjisë së transmetuar ose të shpërndarë, duke dëmtuar efikasitetin e përgjithshëm (përfshirë efikasitetin e energjisë) të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike ose ato që mund të pengojnë pjesëmarrjen e kërkesë-ofertës në balancimin e tregjeve dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kryejnë auditime energjetike vjetore të humbjeve teknike në operatorin e sistemit të rrjetit dhe zbatojnë masat e nevojshme të efikasitetit të energjisë. Këto masa merren parasysh në planin e investimeve të operatorit të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

4. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjislationit për sektorin e energjisë elektrike, ndërmarrin masat e nevojshme për vendosjen e matësve inteligjentë, duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet afatgjata për tregun.

KREU V FONDI PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË

Neni 19

Fondi për Efikasitetin e Energjisë
(Shfuqizuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

Neni 20

Organizimi i Fondit
(Shfuqizuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

Neni 21

Detyrat e Këshillit Drejtues
(Shfuqizuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

Neni 22

Detyrat e Drejtorit Ekzekutiv
(Shfuqizuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

Neni 23

Financimi i Fondit
(Shfuqizuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

Neni 24

Programet e financuara nga Fondi për Efikasitetin e Energjisë
(Shfuqizuar me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

KREU VI AGJENCIA PËRGJEGJËSE PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË

Neni 25

Agjencia Përgjegjëse për Efikasitetin e Energjisë
(Shfuqizuar shkronjat “e”, “f”, “g” të pikës 3 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, krijon agjencinë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, si institucion në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë, dhe përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të saj.

2. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë është person juridik publik, i financuar nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera financimi jashtë Buxhetit të Shtetit, përfshirë burimet e financimeve të huaja, nëpërmjet programeve apo projekteve të ndryshme për promovimin e efikasitetit dhe kursimit të energjisë.

3. Agjencia është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për efikasitetin e energjisë dhe ka detyrat e mëposhtme:

a) të përgatisë, të zbatojë dhe të monitorojë politikat dhe programet për përdorimin efikas të energjisë në sektorët rezidencialë të shërbimeve, të industrisë, të transportit dhe të bujqësisë;

b) të përgatisë dhe të monitorojë Planin Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë;

c) t'i paraqesë çdo vit ministrit një raport të hollësishëm lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë;

ç) të bashkëpunojë me autoritetet qendrore dhe vendore, shoqëritë që operojnë në objektet industriale dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse për krijimin dhe përditësimin e bazës së nevojshme të të dhënave të energjisë, përfshirë llogaritjen e treguesve të efikasitetit të energjisë, si dhe për zbatimin e masave për nxitjen e efikasitetit të energjisë;

d) të përgatisë dhe t'i propozojë ministrit aktet e nevojshme nënligjore për nxitjen e efikasitetit të energjisë, siç parashikohet në këtë ligj;

dh) të përgatisë standardet, normat dhe rregulloret teknike, me qëllim rritjen e efikasitetit të energjisë së pajisjeve, aparaturave dhe makinerive që përdoren për prodhimin, transportin, shpërndarjen dhe konsumin e energjisë në sektorët rezidencialë të shërbimeve, të industrisë, të transportit e të bujqësisë;

e) Shfuqizuar;

ë) të lidhë marrëveshje vullnetare sipas përcaktimeve të nenit 12, pika 3, të këtij ligji;

f) Shfuqizuar;

g) Shfuqizuar;

gj) të koordinojë programet e efikasitetit të energjisë, të financuara nga institucionet ose organizatat ndërkombëtare, mbështetur në marrëveshjet qeveritare;

h) të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare, me qëllim përdorimin me efikasitet të energjisë dhe reduktimin e ndikimit negativ në mjedis;

i) të këshillojë autoritetet e administratës publike vendore, administratorët e ndërtesave publike dhe atyre me destinacion banimi për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të efikasitetit të energjisë;

j) të bashkëpunojë me organet akredituese, për marrjen e informacionit mbi rezultatet e testeve dhe matjeve, për përmbushjen e standardeve kombëtare të efikasitetit të energjisë;

k) të zhvillojë dhe të koordinojë programet e trajnimit;

l) të këshillojë konsumatorët fundorë për programet e efikasitetit të energjisë të ndërmarra prej tyre;

ll) të mbështesë dhe të këshillojë kryerjen e fushatave të ndërgjegjësimi publik dhe veprimtarive të tjera edukative lidhur me nxitjen e efikasitetit dhe kursimit të energjisë;

m) të verifikojë, në rast se e çmon të nevojshme, saktësinë e të dhënave të raporteve të hartuara nga një auditues energjetik;

n) të vendosë masat administrative, sipas nenit 26 të këtij ligji.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Kundërvajtjet administrative dhe gjobat

(Shfuqizuar shkronja "d" e pikës 1 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) mosparaqitja e raporteve, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji, ose paraqitja e raporteve dhe të dhënave të falsifikuara nga shoqëritë që ofrojnë shërbime energjetike, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 1 000 000 lekë;

b) mosraportimi nga konsumatorët e mëdhenj, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 13, të këtij ligji, ose paraqitja e raporteve apo të dhënave të falsifikuara, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

c) mosraportimi nga konsumatorët e tjerë, që nuk kategorizohen si konsumator të mëdhenj, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 13, të këtij ligji, ose paraqitja e raporteve apo të dhënave të falsifikuara, dënohet me gjobë 15 000 lekë;

ç) shkelja e detyrimeve të përcaktuara në pikat 3 dhe 5, të nenit 17, të këtij ligji, nga audituesit energjetikë, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë;

d) Shfuqizuar;

dh) mosraportimi nga konsumatorët fundorë, sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 24, të këtij ligji, ose paraqitja e të dhënave të falsifikuara, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

e) mosraportimi nga palët e treta, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 24, të këtij ligji, ose paraqitja e të dhënave të falsifikuara, dënohet me gjobë 500 000 lekë.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të agjencive përgjegjëse për efikasitetin e energjisë bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

3. Të ardhurat e realizuara nga zbatimi i masave administrative, sipas pikës 1, të këtij neni, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 27

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 1; 10, pika 4; 17, pika 2; 18, pika 3; 20, pika 4 dhe 25, pika 1.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për energjinë që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 5; 8 pikat 1 dhe 3; 13, pika 8; 14, pika 3; 15, pika 4 dhe 18, pika 5.

3. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për ndërtimin që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore në zbatim të nenit 16, pika 8.

Neni 28

Dispozita kalimtare

(Shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 28/2021, datë 8.3.2021)

1. Deri në krijimin e agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, ministria është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga ky ligj.

2. Të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Gjashtë muaj pas botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, konsumatorët e mëdhenj të energjisë deklarojnë tek agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë konsumin e tyre të energjisë për vitin paraardhës sipas formatit të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe të dhënat e

personit të punësuar si menaxher energjie.

4. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, që kanë ngritur sistemin e menaxhimit të energjisë, duhet të dërgojnë certifikatën ISO 50001 brenda 6 muajsh nga publikimi i këtij ligji në Fletoren Zyrtare.

Neni 29

Shfuqizimi i akteve të tjera

Ligji nr. 9379, datë 28.4.2005, “Për efikasitetin e energjisë”, dhe çdo dispozitë ligjore, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohet.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.11.2015.

Shpallur me dekretin nr. 9325, datë 20.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani